



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren  
Prizren Belediyesi

DREJTORIA PER EKONOMI E FINANCA



# RAPORT FINANCIAR

KRAHASIM I SHPENZIMEVE PER VITET 2022, 2023 DHE 2024

**SHKURT** 2025

## HYRJE


Në këtë raport financiar është paaqitur niveli i shpenzimeve sipas kategorive për Komunën e Prizrenit për tri vitet paraprake 2024, 2023 dhe 2022 duke i krahasuar në mes këtyre viteve shpenzimet e ndodhura.

Janë krahasuar shpenzimet për: Paga, Mallra&Shërbime, Shpenzime komunale, Shpenzime kapitale dhe Subvencione për vitet 2022, 2023 dhe 2024.

- Shpenzimet në kategorinë e pagave në vitin 2024 ishin për 6.67% më të larta se në vitin 2023 dhe rreth 30% më shumë se në vitin 2022, pra është një trend i rritjes së shpenzimeve në kategorinë e pagave
- Shpenzimet në kategorinë e mallra&shërbime në vitin 2024 ishin më të larta për 6.35% se në vitin 2023 dhe 24.13% më të larta se në vitin 2022. Edhe tek kjo kategori e shpenzimeve kemi rritje të vazhdueshme në raport me vitet paraprake.
- Shpenzimet në kategorinë "Shpenzime Komunale (Komunalitë) në vitin 2024 ishin më të ulta për -47.47% në krahasim me vitin 2023, ndërsa krahasuar me vitin 2022 këto shpenzime ishin rritur për vetëm 0.36% në vitin 2024. Në vitin 2024 shpenzimet për komunalitë janë ulur ndjeshëm në raport me vitin 2023 dhe janë pothuajse të njëjta me vitin 2022.
- Shpenzimet në kategorinë e subvencioneve në vitin 2024 ishin për 17.28% më të larta se në vitin 2023, ndërsa krahasuar me vitin 2022 shpenzimet për subvencione ishin dukshëm më të larta apo rreth 62% më shumë në vitin 2024.
- Shpenzimet në kategorinë e Investimeve kapitale, në vitin 2024 ishin më të larta për 24% krahasuar me vitin paraprak 2023 dhe rreth 105% më të larta krahasuar me vitin 2022.


Në dy kategoritë e shpenzimeve të cilat janë shumë të rëndësishme për jetën e qytetarëve të Komunës, shihet që shpenzimet janë rritur dukshëm si në kategorinë e Investimeve Kapitale e po ashtu edhe në kategorinë e Subvencioneve në vitin 2024 në raport me dy vitet paraprake 2023 dhe 2022.

DREJTORITË/ZYRET	SHPENZIMET PËR PAGA			SHPENZIMET PËR MALLRA&SHËRBIME			SHPENZIMET KOMUNALE (KOMUNALITË)			SHPENZIMET KAPITALE			SUBVENCIONET		
	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024	2022	2023	2024
KRYETARI-ASAMBLEJA KOMUNALE	227,957	306,550	304,998	99,914	102,361	-	-	-	-	-	-	-	1,990,054	3,508,216	4,003,875
DREJTORIA E ADMINISTRATËS	449,917	477,868	492,460	999,626	1,105,301	1,015,898	83,917	717,953	54,654	88,251	104,862	346,437	-	-	-
DREJTORIA E INSPEKTORIATIT	134,548	186,687	198,550	98,562	60,791	66,694	-	-	-	-	-	-	-	-	-
ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	170,772	357,757	391,701	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	215,846	242,427	292,388	348,429	358,486	622,346	46,757	-	97,884	-	30,000	428,432	-	-	-
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE	480,125	643,105	640,849	2,601,030	3,573,537	3,128,072	335,591	477,832	329,659	8,355,842	13,580,301	15,621,312	-	-	-
ZYRA E KOMUNITETEVE	36,618	37,433	40,378	30,000	39,335	48,907	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DREJTORIA E BUJQËSISË	115,371	129,212	66,085	278,676	214,353	243,107	-	-	-	226,084	387,242	868,387	544,034	-	86,523
DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKON	31,812	45,787	36,534	108,994	105,552	88,820	-	-	-	239,306	375,628	742,616	-	-	-
DREJTORIA E GJEODEZISË DHE KADASTRIT	96,972	120,225	127,520	11,200	21,220	21,804	-	-	-	-	-	-	-	-	-
DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT	81,919	105,616	114,194	268,847	548,557	597,285	-	-	-	5,660	150,000	-	-	-	-
DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	226,354	353,674	386,595	245,729	784,802	1,261,344	-	-	-	389,465	1,154,706	1,363,148	28,300	29,750	59,000
DREJTORIA E MIRËQENIES SOCIALE	238,932	245,925	336,063	773,147	898,419	873,179	1,103	588	18,536	213,356	138,840	580,394	-	-	-
DREJTORIA E ARSIMIT	14,748,450	17,914,856	19,324,265	2,821,164	2,410,178	2,519,635	228,850	224,972	225,575	1,279,102	2,314,578	2,382,985	-	-	-
DREJTORIA E SHËNDETËSISË	3,843,121	4,541,885	4,666,592	1,450,420	1,607,007	2,094,495	121,910	149,404	94,773	854,905	964,321	1,489,332	-	-	-
GJITHSEJ	21,098,714	25,709,009	27,419,172	10,135,739	11,829,897	12,581,586	818,129	1,570,749	821,081	11,651,971	19,200,477	23,823,042	2,562,388	3,537,966	4,149,398



## KRYETARI DHE ASAMBLEJA KOMUNALE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Shpenzimet në zyrën e Kretarit të Komunës kanë qenë vetëm në tri kategori, atë pagave, mallra&shërbime dhe subvencioneve.

Kategoria që ka rritje të theksuar të shpenzimeve të cilat janë pjesë e zyrës së Kryetarit të Komunës janë subvencionet, ku shihet një trend i rritjes së tyre. Në vitin 2022 këto shpenzime ishin rreth 1.9 milion euro, në vitin 2023 janë rritur për 1.5 milion euro më shumë se në vitin 2022 më saktësisht rreth 3.5 milion euro apo 76%, ndërsa në vitin 2024 krahasuar me vitin 2022 shpenzimet për subvencione janë rritur përafërsisht 2 milion euro apo rreth 101% më shumë. Ndërsa në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 shpenzimet për subvencione ishin rritur për rreth 0.5 milion euro më shumë.

## DREJTORIA E ADIMINISTRATËS

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Në Drejtorinë e Administratës shpenzimet më të larta kanë qenë në kategorinë e Mallra&Shërbimeve, pastaj pagat, shpenzimet komunale dhe investimet kapitale. Në vitin 2022 shpenzimet në kategorinë e mallra&shërbimeve ishin rreth 1 milion euro, në vitin 2023 këto shpenzime ishin rritur për 100,000 euro apo 1.1 milion euro, ndërsa në vitin 2024 këto shpenzime përsëri kishin pësuar një ulje rreth 90,000 euro më pak duke zbritur përsëri në rreth 1.01 milion euro.

Shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale në vitin 2022 ishin rreth 88 mijë euro, në vitin 2023 këto shpenzime ishin rritur rreth 16 mijë euro më shumë apo rreth 19% më shumë shpenzime. Në vitin 2024 investimet kapitale kapin vlerën e rreth 346 mijë eurove apo rreth 242 mijë euro më shumë se në vitin 2023 dhe 258 mijë euro më shumë se në vitin 2022. Pra ka një rritje të lehtë të investimeve kapitale nga drejtorja e administratës në vitin 2024 krahasuar me dy vitet paraqite.

## DREJTORIA E INSPEKTORIEVE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Siç shihet nga të dhënat më lartë, Drejtoria e inspektorateve në tre vitet e fundit ka pasur shpenzime vetëm në kategoritë e Pagave dhe Mallra&Shërbim.

Nga grafiku më lartë vërejmë që shpenzimet nga kategoria e pagave nga viti 2022 deri në vitin 2024 kanë pasur rritje deri në 47.5 % në vitin 2024, ndërsa shpenzimet nga kategoria mallra&shërbime në vitin 2023 në raport me vitin 2022 janë ulur për rreth 38 mijë euro, ndërsa në vitin 2024 janë rritur sërish për rreth 6 mijë euro krahasuar me vitin 2023, por kanë mbetur më të ulta në raport me vitin 2022.

## ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL


Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024



Zyra e Kuvendit komunal ka pasur vetëm një kategori të shpenzimeve, atë të pagave. Shpenzimet për pagat janë rritur nga viti në vit përgjatë këtyre tre viteve. Në vitin 2023 shpenzimet në kategorinë e pagave janë rritur për 187 mijë euro më shumë se në vitin 2022 apo shprehur në përqindje rreth 109 % më shumë. Po ashtu edhe në vitin 2024 në raport me vitin 2023 ka pasur rritje të shpenzimeve për pagat për rreth 34 mijë euro më shumë apo 9.5% më shumë.

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024



Sipas të dhënave të prezentuara në grafik, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa shpenzime ka pasur në katër kategori, atë të pagave, mallrave, shpenzimeve komunale (komunalitë) dhe investime kapitale.

Shpenzimet më të dukshme dhe me vlerë më të madhe siç edhe shihet në grafik janë ato në kategorinë Mallra&shërbime. Në vitin 2024 krahasuar me dy vitet paraprake atë 2023 dhe 2022 shpenzimet në këtë kategori ishin për 264 mijë euro më shumë apo shprehur në përqindje rreth 74 % më shumë.


Po ashtu edhe në kategorinë e pagave shpenzimet kanë pasur rritje nga viti në vit përgjatë këtyre tre viteve të fundit 2022, 2023 dhe 2024.

Shpenzimet nga kategoria e Investimeve kapitale janë rritur dukshëm në vitin 2024 në raport me vitin 2023 rreth 400 mijë euro më shumë apo shprehur në përqindje 1328 % më shumë, mirëpo kjo ka ardhur si pasojë e pagesave për me procedura përmbarimore.



## DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Drejtorja e Shërbimeve Publike e Komunës së Prizrenit shpenzimet më të larta i kanë ndodhur në kategorinë e Investimeve kapitale e cila është e pritshme duke e ditur rolin e kësaj drejtorie.

Siç shihet edhe në grafikun më lartë shpenzimet në kategorinë e Investimeve Kapitale në tri vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 janë rritur në mënyrë të theksuar nga viti në vit. Në vitin 2023 në raport me vitin 2022 këto shpenzime ishin rritur për rreth 5 milion euro më shumë apo 62.5 % më shumë, ndërsa në vitin 2024 investimet kapitale ishin rritur mbi 7 milion euro më shumë së në vitin 2022 apo rreth 87 % më shumë. Po ashtu në vitin 2024 investimet kapitale ishin më të larta edhe nga viti 2023 për rreth 2 milion euro apo rreth 15 % më shumë investime kapitale.

Kategori tjetër e shpenzimeve e cila ka vlera relativisht të larta janë Mallra&Shërbimet, shpenzime këto të cilat kanë pësuar luhatje në tri vitet e fundit siç edhe shihet në grafikun e paraqitur.

## ZYRA E KOMUNITETEVE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Ni zyren e komuniteteve gjatë tri viteve të fundit ka pasur shpenzime vetëm në dy kategori, atë të pagave dhe mallra&shërbimeve.

Shpenzimet në kategorinë e pagave janë rritur nga viti në vit, nëse e krahasojmë vitin 2024 me dy vitet paraprake atë 2023 dhe 2022 shpenzimet e pagave janë rritur me rreth 3 mijë euro apo shprehur në përqindje rreth 8 % përafërsisht. Po ashtu edhe shpenzimet në kategorinë mallra&shërbime janë rritur përgjatë tre viteve të fundit. Në vitin 2024 këto shpenzime ishin më të larta krahasuar me dy vitet paraprake 2023 dhe 2022, rreth 18 mijë euro më shumë se në vitin 2022 dhe rreth 9 mijë euro më shumë se në vitin 2023.

## DREJTORIA E BUJQËSISË

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Në shpenzimet e Drejtorisë së Bujqësisë ajo që vihet re më shumë janë dy kategori e shpenzimeve, Subvencionet dhe Investimet kapitale.

Në kategorinë e Investimeve kapitale shihet rritje e vazhdueshme e investimeve kapitale nga vitit në vit përgjatë tre viteve të fundit. Në vitin 2024 këto shpenzime ishin rritur për rreth 500 mijë euro më shumë se në vitin 2023 dhe mbi 600 mijë euro më shumë se në vitin 2022, kjo kishte ndodhur si pasojë e rritjes së investimeve në ndrtimin e rrugëve fushore të cilët u ndihmojnë bujqëve në qasje më të lehtë në pronat e tyre bujqësore.

Po ashtu ajo që vërehet nga grafiku i shpenzimeve në këtë drejtori janë edhe subvencionet, ku në vitin 2022 ato ishin rreth gjysmë milion euro, ndërsa në vitin 2024 këto shpenzime ishin dukshëm më të ulta me rreth 86 mijë euro. Kjo ka ndodhur si pasojë që këto shpenzime tanimë bëhen përmes zyrës së Kryetarit të Komunës, për këtë arsye në shikim të parë duket që janë zvogëluar këto shpenzime por në fakt ato tani bëhen nga zyra e kryetarit për bujqërit.

## DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Në Drejtorinë e Turizmit dhe zhvillimit ekonomik ajo që bie më shumë sy janë shpenzimet për investime kapitale të cilat janë rritur rreth 500 mijë euro më shumë në vitin 2024 krahasuar me atë 2022, dhe me rreth 370 mijë euro më shumë se në vitin 2023. Pra shihet që shpenzimet nga kategoria e investimeve kapitale kanë trend rritës nga viti në vit.

Shpenzimet në kategorinë e pagave në vitin 2024 kanë qenë më të ulëta për rreth 9 mijë euro se në vitin 2023.

## DREJTORIA E GJEDOEZISË DHE KADASTRIT

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Në Drejtorinë e Gjedoëzisë dhe Kadastrit janë vetëm dy kategori të shpenzimeve, ajo e pagave dhe mallra&shërbimeve.

Nga të dhënat në grafikun më lartë, shpenzimet e pagave janë rritur vazhdimisht nga viti 2022 deri në atë 2024. Në vitin 2024 shpenzimet për paga ishin për rreth 30 mijë euro më shumë se në vitin 2022 dhe rreth 7 mijë euro më shumë se në vitin 2023. Kjo mund të ketë ndodhur nga shumë faktorë siç janë rekrutimi apo ndryshimet në paga etj. Shpenzimet për mallra&shërbime përveç vitit 2022 të cilat ishin më të ulëta, në dy vitet e fundit 2023 dhe 2024 ato ishin pothuajse konstante duke mos pësuar shumë ndryshime të dukshme.

## DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR


Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024



Shpenzimet më të mëdha në Drejtorinë e Urbanizmit përgjatë tre viteve të fundit ishin në kategorinë e Mallra&Shërbimeve të cilat janë rritur. Nëse e krahasojmë vitin 2024 me vitin 2022, shpenzimet në këtë kategori ishin rritur për 330 mijë euro më shumë se në vitin 2022, ndërsa vetëm rreth 50 mijë euro më shumë se në vitin 2023. Po ashtu shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale ka pasur vetëm në dy vitet paraprake 2023 dhe 2022 dhe jo në vitin 2024.

## DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Shpenzimet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport përfshijnë katër kategori: pagat, mallrat, subvencionet dhe investimet kapitale. Dy kategori me pjesëmarrjen më të lartë të shpenzimeve të ndodhura në këtë drejtori janë: shpenzimet në kategorinë e Mallra&Shërbime dhe Investime Kapitale.

Shpenzimet në M&SH në tri vitet e fundit janë rritur në mënyrë të vazhdueshme. Në vitin 2024 janë shpenzuar rreth 470 mijë euro më shumë se në vitin 2023 dhe mbi 1 milion euro më shumë se në vitin 2022. Kjo mund të ketë ndodhur si pasojë e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe renovime të ndryshme të cilat janë paguar nga kategoria e mallra&shërbimeve.

Po ashtu një kategori tjetër e rëndësishme e shpenzimeve janë investimet kapitale, të cilat janë rritur dukshëm në tre vitet e fundit. Në vitin 2024 shpenzimet për investime kapitale ishin rritur me mbi 200 mijë euro më shumë krahasuar me vitin 2023 dhe rreth 1 milion euro më shumë krahasuar me vitin 2022, pra siç shihet dy vitet e fundit 2023 dhe 2024 krahasuar me vitin 2022 janë dukshëm më të larta shpenzimet.

## DREJTORIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ajo që vërehet më shumë janë shpenzimet në kategorinë e Mallra&Shërbimeve, Investimeve Kapitale dhe Pagave.

Shpenzimet në kategorinë e M&SH përgjatë tri viteve të fundit 2022, 2023 dhe 2024 edhe pse në nivele të larta nuk kanë pasur shumë ndryshime duke mbetur pothuajse në nivelin e njëjtë të shpenzimeve, ndërsa ajo që vërehet më shumë për ndryshime më të mëdha në shpenzime janë Investimet Kapitale. Në vitin 2024 këto shpenzime ishin për rreth 500 mijë euro më shumë se në vitin 2023 me vlerë totale prej 580 mijë eurove, ndërsa në vitin 2024 këto shpenzime kapnin vlerën prej 138,480 euro.



## DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Shpenzimet në kategorinë e pagave janë ato që e karakterizojnë Drejtorinë e Arsimit, duke mos i anashkaluar edhe shpenzimet për investime kapitale.

Nga të dhënat në grafik shohim se shpenzimet për paga janë rritur nga viti 2022 deri në vitin 2024 me një ritëm të njëjtë pothuajse. Në vitin 2024 shpenzimet për paga kapin vlerën e rreth 19.3 milion eurove apo 1.6 milion euro më shumë se në vitin 2023, shprehur në përqindje rreth 8 % më shumë. Ndërsa në raport me vitin 2022, shpenzimet për pagat në vitin 2024 ishin më të larta për rreth 4.5 milion euro më shumë apo 31 % më shumë shpenzime. Këto shpenzime të larta janë si pasojë e një numri të konsiderueshëm të mësimdhënësve e cila ndikon që të rriten shpenzimet për paga më shumë krahasuar me drejtoritë tjera komunale, po ashtu një faktor tjetër në rritjen e shpenzimeve është edhe rritja e pagave nga niveli qëndror.

Shpenzimet për investime kapitale në vitin 2023 dhe 2024 kanë mbetur pothuajse të njëjta me rreth 2.3 milion euro në secilin vit, ndërsa në vitin 2022 ato ishin rreth 1.3 milion euro, pra ka një rritje prej rreth 1 milion euro më shumë në vitet 2023 dhe 2024 në raport me vitin 2022.

## DREJTORIA SHËNDETËSISË

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024




Pjesën dërmuese të shpenzimeve në Drejtorinë e Shëndetësisë e zënë shpenzimet në kategorinë e pagave, kjo për arsye që numrii punonjësve është më i madh krahasuar me drejtoritë tjera komunale duke përjashtuar drejtorinë e arsimit. Nga të dhënat e analizuara shihet që shpenzimet për paga kanë pasur rritje të theksuar nga viti 2022 deri në vitin 2024. Në vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet për paga pothuajse ishin konstante në këtë drejtori me 4.6 përkatësisht 4.5 milion euro. Ndërsa në vitin 2022 këto shpenzime ishin rreth 3.8 milion euro, pra shihet një rritje me 700 deri 800 mijë euro në vitin 2024 dhe 2023 me vitin 2022. Po ashtu edhe shpenzimet në kategorinë Mallra&Shërbime dhe Investime kapitale shihet se janë rritur dukshëm nga viti 2022 deri në vitin 2024.

Shpenzimet me nivelin më të ulët janë ato të shpenzimeve komunale (komunalitë) të cilat në vitin 2024 janë më pak krahasuar me vitet 2022 dhe 2023.

## SHPENZIMET SIPAS KATEGORIVE NË NIVEL KOMUNAL PËR TRE VIETET PARAPRAKE 2024, 2023 DHE 2022

Shpenzimet në kategorinë e pagave, mallra&shërbime, shpenzimet komunale, subvencionet dhe investimet kapitale për 2022, 2023 dhe 2024



Përveç shpenzimeve komunale (komunalitë) në nivel komunal, të gjitha kategoritë tjera të shpenzimeve në Komunën e Prizrenit janë rritur vazhdimisht vit pas viti. Shpenzimet në kategorinë e paga përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme në secilin vit. Në vitin 2024 këto shpenzime ishin në vlerë prej rreth 27.4 milion euro apo rreth 1.7 milion euro më shumë se në vitin 2023, shprehur në përqindje rreth 6.6 %. Ndërsa në raport me vitin 2022 shpenzimet e pagave ishin më të larta në vitin 2024 për rreth 6.3 milion euro apo rreth 29% më shumë.

Në kategorinë Mallra&Shërbime shpenzimet po ashtu ishin në rritje të vazhdueshme në tri vitet e fundit. Në vitin 2024 këto shpenzime kapnin vlerën e rreth 12.5 milion euro apo 700 mijë euro më shumë se në vitin 2023 apo rreth 6 %. Ndërsa në raport me vitin 2022 shpenzimet në këtë kategori në vitin 2024 ishin më të larta për rreth 2.4 milion euro më shumë apo 24 %.

Po ashtu rritje e dukshme e shpenzimeve ishte edhe në kategorinë e subvencioneve, në vitin 2024 shpenzimet për subvencione ishin në vlerë prej rreth 4.15 milion euro apo rreth 600 mijë euro më shumë se në vitin 2023, shprehur në përqindje rreth 17.5 % më shumë. Ndërsa në raport me vitin 2022,

shpenzimet për subvencione në vitin 2024 ishin më të larta për rreth 1.6 milion euro krahasuar me vitin 2022 apo shprehur në përqindje rreth 62 % më shumë shpenzime.

Edhe tek kategoria e shpenzimeve për Investime Kapitale kemi një rritje të ndjeshme të shpenzimeve në tri vitet e fundit ku në secilin vit këto shpenzime janë rritur. Në vitin 2024 shpenzimet për investime kapitale kapnin vlerën prej 23.8 milion euro apo rreth 4.6 milion euro më shumë krahasuar me vitin 2023 apo shprehu në përqindje rreth 24 % më shumë shpenzime, ndërsa në raport me vitin 2022 shpenzimet për investime kapitale në vitin 2024 ishin rreth 12.2 milion euro më shumë apo shprehur në përqindje rreth 105 % më shumë shpenzime. Nga viti 2023 shpenzimet për investime kapitale janë rritur dukshëm në raport me vitet paraprake në Komunën e Prizrenit.